



GAZETA

Këshilli për etikë në media
në Maqedoni

Viti 2015

numri 1

Përmbajtje

- Komisioni për ankesa pranë KEMM në vizitë të Këshillit të Bosnjës për shtyp 2
- Tryezë të rrumbullakët për luftë kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit 2
- KEMM ka shqyrtuar 50 ankesa të qytetarëve 2
- KEMM në shënimin e ditës botërore të lirisë të mediave 3
- Pjesëmarrje në konferencën “Liria e të shprehurit: A është ende parakusht për demokraci?” 3
- Është mbajtur kuvendi vjetor i KEMM... 4

INTERVISTA

- Katerina **BLLAZHEVSKA**..... 4
- Enes **OSMANÇEVIQ**..... 5
- Martin **HAKERBI**..... 7

Debate nëpër Maqedoni për të njoftuar publikun me punën e KEMM-it



Në periudhën prej prillit deri në qershor të vitit 2015, Këshilli për etikë në media në Maqedoni ka mbajtur gjashtë debate në regjione të ndryshme në shtet, gjegjësisht në Manastir, Ohër, Shtip, Strumicë, Tetovë dhe Kumanovë. Anëtarët e Bordit Drejtues, Komisioni për Ankesa dhe Zyrës ekzekutive I njoftuan të pranishmit me principin e vetëregullimit të mediave, përvojat e deritanishme të Këshillit, si dhe për bashkëpunimin me trupat e ngajshëm në korniza ndërkombëtare.

Ngjarjet u përdorën edhe për të prezentuar rastet më interesante të cilat deri tani kanë qenë të përpunuara nga Komisioni për ankesa pranë KEMM, si dhe për efektin e mediacionit e cila është njëra prej mjeteve kryesore të cilat I përdor Këshilli për të zgjidhur ankesat për gazetari jo profesionale dhe joetike. Në debatet morrën pjesë diku rreth 130 qytetarë, në mesin e të cilëve kishte përfaqësues të mediave, sektorit civil, vetëqeverisjes lokale, institucionet shtetërore etj.

KEMM është themelues i Media NETiks



KEMM është njëri prej themeluesve të Media NETiks – Rrjeti i trupave për vetëregullim në media në Evropën Juglindore. Në qershor të këtij viti, nën patronazhin e Këshillit të Evropës, në konferencën dy ditore në Budva, Mal i Zi, u zyrtarizua themelimi i Media NETiks – Rrjeti i trupave për vetëregullim në media në Evropën Juglindore. Themelues të rrjetit janë trupat për vetëregullim në mediat në Maqedoni, Sërbi, Kosovë, Mal i Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Detyra i këtij bashkimi regjional do të jetë ngritja e vetëdijes të anëtarëve të rrjetit, mediave, profesionistëve medial, dhe shoqërisë në tërësi, për principet themelore për vetëregullim dhe profesionalizëm, si dhe shqyrtimi i ankesave jashta kufijve të vendeve në regjion.

KEMM edhe zyrtarisht anëtare e AIPCE



Këshilli për etikë në media në Maqedoni në Kuvendin e sivjetshëm të këtij rrjeti zyrtarisht u pranua si anëtare e Aliancës të këshillave të pavarur për etikë në Evropë (AIPCE). Kuvendi vjetor i Aliancës u mbajt me 8 dhe 9 tetor, në Vienë. Në këtë ngjarje morri pjesë drejtoresha e Këshillit, Marina Tuneva.

AIPCE është themeluar në vitin 1999 në Londër dhe është rrjeti i lirë të regulluesve të pavarur për mediat elektronik dhe të shtypur. Konferencat vjetore të saj sigurojnë një forum për përfaqësuesit e këshillave për etikë në media, për të folur rreth pyetjeve aktuale, të shkëmbejnë idetë dhe të ofrojnë dhe pranojnë ndihmë të nevojshme. Në deklaratën për qëllimet e Aliancës janë të vendosura

sigurimet thelbësore të organizatave të cilat marrin pjesë në të:

- Atë se regullimi i përmbajtjes redaktuese në mediat duhet të jetë e pavarur nga pushteti,
- Atë se regullimi e përmbajtjeve mediatiqe, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për media nacionale apo regjionale, duhet të themelohet në kulturat dhe kombet e ndryshme,
- Atë se shkruajtja e kodekseve për etikë gazetareske dhe zbatimi i tyre është punë e gazetarëve dhe botuesve, të cilit i marrin parasysh qëndrimet e publikut e jo të pushtetit,
- Atë se mundet të veprohet sipas kodeksit universal për etikë.

KEMM ka shqyrtuar 50 ankesa nga qytetarët

Në periudhën e kaluar qytetarët më së shumti janë ankuar për gjuhë të urrejtjes në media, informata jo të sakta dhe jo të balancuara, prishje të imazhit të palëve të involvuara, pala e dytë nuk është përfaqësuar, shpifje, fyerje dhe diskriminim.

Sipas strukturës të parashtruasve të ankesave, më së shumti komisionit u kanë drejtuar, mediat, gjegjësisht redaktorë të punësuar edhe gazetarë. Pastaj në radhë janë, individ, qytetarë, politikan, institucione, dhe shoqata qytetare. Duke parë sipas saj se për çfarë media janë parashtruar ankesat, udhëheqin portalet.

Komisioni i KEMM për ankesa në vizitë të Këshillit të Bosnjës për shtyp



Në qershor të këtij viti, bashkëpunimi ndërkombëtar i Këshillit për etikë në media në Maqedoni u thellua me takimin e punës me kolegët nga Këshilli i Bosnjës për shtyp. Anëtarë e Komisionit për ankesa pranë KEMM, kryetari Mirçe Adamçevski dhe anëtarët Filip Gjurčinovski dhe Teofil Bllazhevski, me thirje paraprake, morrën pjesë në mbledhjen e komisionit për Ankesa të Këshillit të Bosnjës për shtyp. Në mbledhjen, kolegët e Bosnjës shqyrtuan ankesa të parashtruara para organit të tyre. Ndërsa, anëtarët e Komisionit të Maqedonisë për ankesa kishin mundësi të njoftohen me procedurat dhe praktikat e kolegëve të tyre nga Bosnja, mënyrës të zgjidhjes të ankesave dhe pregaditjes të vendimeve, gjegjësisht arsyetimeve.

Tryezë e rrumbullakët për luftë kundër gjuhës të urrejtjes dhe diskriminimit



Me 2 tetor KEMM dhe Instituti i Maqedonisë për media (IMM), pranë kornizave të proektit regional "Pik vëzhgimi medial I Evropës Juglindore" i finansuar nga BE-ja, organizuan tryezë të rrumbullakët me temë "Shqyrtimi i gjuhës të urrejtjes dhe diskriminimit – ndikimi i redaktorëve dhe sfidat me të cilat ballafaqohen".

Në tryezën e rrumbullakët u drejtua Shefi i delegacionit të BE-së E.T. Aivo Orav, a fjalimet e veta i kishin edhe përfaqësuesit e Këshillit për etikë në media dhe Komisioni për ankesa.

Qëllimi i kësaj ngjarjeje ishte të hapet debat për rolin dhe ndikimin e redaktorëve në ndalimin e gjuhës të urrejtjes dhe diskriminimit në media. Nga diskutimi i të pranishmëve dolën këto vendime dhe rekomandime:

- Të ketë bashkëpunim përmes trupit regullues dhe trupit vetëregullues, veçanarisht në shfrytëzimin e përbashkët të resurseve në shqyrtimin e rasteve ku ka gjuhë të urrejtjes në media;
- Mediat të raportojnë për gjuhë të urrejtjes, por të shenohet si i tillë dhe qartë të bëhet me dije se bëhet fjalë për ashtu lloji të problemit;

- Të rritet angazhimi i Komisionit për mbrojtje prej diskriminimit në identifikimin e rasteve ku ka gjuhë të urrejtjes, a veçanarisht në pjesën e ndëshkimit;
- Gazetarët dhe personat të cilit e shfrytëzojnë median për të ushqyer gjuhën e urrejtjes të mbajnë përgjegjësinë e duhur, a profesionistët gazetarë të bashkohen për distancimin e tyre nga hapësira mediale;
- Është i nevojshëm kordinim dhe përputhshmëri përmes institucioneve të ndryshme, organizata dhe rrjete në luftën kundër gjuhës të urrejtjes dhe diskriminimit;
- Të zvoglohet ndikimi i qendrave me fuqi dhe ndikim politik mbi punën e mediave;
- Nevojitet profesionalizimi i punës të gazetarëve si në servis publik ashtu edhe në mediat tjera, gjegjësisht të punohet në edukim të vazhdueshëm;
- Vetëregullimi më shpesh të përdoret si mekanizëm për të reaguar ndaj gjuhës të urrejtjes, fyerrjes, shpifjes dhe dukurive të tjera të thyerjes të Kodeksit të gazetarëve;
- Redakcionet të kenë Kodeksin e tyre të cilin do ta respektojnë në korniza të redakcionit, ndërsa Internet portalet të dakordojnë principe të mbrendshme të sjelljes;
- Të krijohet Kodeksi i ri të mediave të shtypura, elektronike dhe ato të internetit.



U mbajt kuvendi vjetor i KEMM

Kuvendi i regullt vjetor i KEMM u mbajt me 27 maj, në Shkup.

U prezentuan dhe njëzëri u pranuan raporti i punës të zyrës ekzekutive, raporti nga puna i Komisionit për ankesa dhe raporti për punën financiare dhe materijale të Këshillit, u diskutuan planet për të ardhmen dhe aktivitetet konkrete të cilat Këshilli do t'i realizon.



KEMM në shënimin e ditës Botërore të lirisë të mediave



Kryetarja e KEMM Katerina Sinadinovska dhe kryetari i Komisionit për ankesa Mirçe Adamçevski morrën pjesë në konferencën ndërkombëtare e organizuar nga UNESCO-ja për të shënuar ditën Botërore të lirisë të mediave. Konferenca është mbajtur në Riga, me 2-4 maj.

Gjatë konferencës u prezentuan puna e KEMM, planet për aktivitetet e ardhshme, a u diskutuan edhe mundësi të mundshme në të ardhmen për bashkëpunim dhe partneritet me organizata dhe trupa të ndryshëm.

"Kur i diskutojmë sfidat me të cilat ballafaqohemi, duhet të kemi parasysh edhe sukseset kolektive të këshillave tonë vitet e kaluara. Edhe përkrah buxheteve të ulëta që kemi, kemi realizuar shumë aktivitete për të ngritur vetëdijen e qytetarit, kemi trajnuar gazetarë dhe redaktorë dhe kemi pranuar më shumë ankesa. Duhet të vazhdojmë me këtë punë të rëndësishme edhe në të ardhmen", deklaroi Katerina Sinadinovska në këtë ngjarje.



**FREEDOM OF EXPRESSION:
STILL A PRECONDITION
FOR DEMOCRACY?**

**LA LIBERTÉ D'EXPRESSION
EST-ELLE ENCORE
UNE CONDITION NÉCESSAIRE
À LA DÉMOCRATIE?**



Pjesëmarrje në konferencën "Liria e shprehjes: a është akoma parakusht për demokraci?"

Drejtoresha e KEMM, Marina Tuneva, me 13 dhe 14 tetor morri pjesë në konferencën "Liria e shprehjes: a është ende parakusht për demokraci?". Konferenca u mbajt në Strazbur dhe ishte e organizuar nga Këshilli i Evropës.

Ngjarja ishte e fokusuar në lirinë e shprehjes në Internet, a diskutoheshte reth tre temave kryesore: Regullat e demokracisë kur janë në konflikt më shumë se një e drejtë kryesore; konteksti për ndjeshmëri më të madhe në shoqëri; dhe mënyra për integrim të Internetit në pejsazhin e tanishëm për mbrojtje të lirisë e të shprehurit.

INTERVISTË

Katerina BLLAZHEVSKA



Me Katerina Bllazhevska-n biseduam për situatën me respektimin e standardeve etike dhe profesionale në profesionin gazetaresk në Maqedoni, nga pikëpamja e gjendjes gjatë tranzicionit edhe asaj se çka ka ndodhur 15 vitet e fundit.

“Çdo gazetarë duhet të reflektojë se vallë i respekton edhe sa standardet profesionale, a është mposhtur nga cenzurimi apo vetëcenzurimi, liria gazetareske a iu është cenuar nga joliria ekonomike, gjegjësisht nga varshmëria prej rrogës edhe prej preferencave politike të punëdhënësit” – thotë Katerina Bllazhevska, në intervistën për Këshillin për etikë në media në Maqedoni.

Mbrojtja kolektive e standardeve profesionale mundet të jetë efikase vetëm nëse mbeshtetet edhe në mbrojtjen individuale të tyre

KEMM: Si do t'a kishit përshkruar gjendjen e respektimit të standardeve etike dhe profesionale të gazetarisë në shtet?

K.B: Me respekt për disa media që do t'i kisha veçuar, në Maqedoni standardet etike dhe profesionale në gazetari pothuajse janë të gjitha të përjashtuara nga profesioni. Me një fjalë, ekzistojnë, për tu shkelur në mënyrë brutale për çdo ditë.

KEMM: Me atë që vite të gjata jeni në profesionin gazetaresk, si gazetarë, edhe si redaktore, të cilat trende dhe faza do t'i kishit identifikuar drejt respektimit të standardeve profesionale në gazetari, nga pavarësimi i Maqedonisë, deri tek ajo që është duke ndodhur tani?

K.B: Në periudhën menjëher para edhe pas pavarësimit, rëndësia dhe roli i standardeve profesionale shënonte ritje në mënyrë intezive përkundër cilësisë të respektimit të tyre. Pluralizmi partiak, i cili ishte në fillimin e tij, ndikimin e tij e kishte edhe te mediat. Kjo në mënyrë të madhe rezultoi me pluralizim të mendimeve, debate, produkte gazetareske objektive dhe profesionale, në të cilat, pa censurë dhe pa kufizime, kishte hapësirë për të shprehur qëndrime të ndryshme. Kjo ishte periudhë ku mediat filluan të ndërtonin kuptimin e tyre esencial e jo vetëm atë frazor si "fuqia e shtatë ose" pushteti i katërt". Ata ishin dritarja profesionale dhe demokratike edhe në vitin 1994, kur Kuvendi mbeti pa opozitë parlamentare. Pas atij viti, në fakt filloi ngjyrosja partiake e mediave, fillimisht televizionet, përmes të përdorimit të pronarëve të tyre si koalicioner ose deputet. Ky llojë ndikimi vazhdoi edhe më tutje. Në gjith atë periudhë deri më sot, për arsye të ndik-

imit të madh partiak edhe qeveritar edhe me shtypje ndaj mejnstream mediave, gazetaria është në rënie të lirë, a standardet profesionale janë dy metra nën tokë. Periudhë e cila veçohet nga kjo është kur ishte qeveria e Ljubço Georgievskit, kur mediat së paku nuk ishin nën ndikimin e pushtetit.

KEMM: Cilat aspekte të shkeljes të standardeve profesionale dhe etike sipas jush janë më brengosëse?

K.B: Brengosë mosrespektimi elementar i Kodeksit. Por, ky nuk është problem i vetëm. Nëse në dekadën e kaluar e sheni sundimi i mediave nga politika, në dekadën e dytë ky trend jo vetëm që vazhdoi me intezitet më të madhë por edhe u zhvillua me zbrapsim rrënjësor të gazetarisë, përmes instalimit të një filtri medial të dobët, i cili lëshoi shumë persona me pa njohuri elementare. Rezultati i kësaj sot është: Gazetari e kontrolluar edhe gazetari e analfabetave!

KEMM: Sa edhe nga cila pikëpamje mendojnë se zgjerimi i mediave të reja të internetit në vitet e fundit ndikon në situatën?

K.B: Në këtë situatë kur secili mundet të bëhet gazetar, pa pasur nevojë të përmbush kritere arsimore dhe standarde profesionale, dhe kur rrjetet sociale u shëndruan në platformë kryesore për prodhim dhe këmbim të informatave, dhe më së shpeshti janë 'gjysëm produkte', pjesë e internet mediave u bënë shpërndarës edhe reciklues të mu këtyre "produkteve". Nga ana tjetër, pjesë e internet mediave të cilit me këmbëngulje ju mbahen standarde profesionale, në këtë kaos ato bëhen të padukshëm, duke përshkruar me thënien " nga pylli nuk duken pemët". Metastazimi i joprofesionalitetit

në internet hapësirën, pa arsytim hudhë njollë edhe mbi ato.

Në tërësi, pjesë e internet mediave edhe më shumë e njollosin fotografinë egzistuese, a ata të tjerit të cilit janë pakicë në profesionalitetin e tyre, edhe pse japin shpresë të madhe, prapë se prapë nuk kanë sukses më shumë të kenë ndikim në ndryshimin e gjendjes në tërësi.

KEMM: Si do t'a kishit vlerësuar rolin e bashkësisë mediale në mbrojtje të standardeve profesionale, dikur dhe tani?

K.B: Si e shpërndarë, jo e kordinuar dhe e ndarë. Mbrojtja kolektive e standardeve profesionale mundet të jetë efikase, vetëm nëse themelohet edhe në mbrojtjen e tyre individuale. Bashkësia nuk mundet të korrë sukses nëse individët çdo ditë i rrënojnë ato standarde.

KEMM: Sipas jush, prej ku duhet të filloje "rehabilitimi" i profesionit dhe kthimi i standardeve themelore gazetareske, dhe ku e shikoni rolin e mekanizmave vetëregulluese?

K.B: Rehabilitimi duhet të filloje nga individi. Çdo gazetarë duhet të reflektojë se a vallë i respekton edhe sa standardet profesionale, a është mposhtur nga cenzurimi apo vetëcenzurimi, liria gazetareske a iu është cenuar nga joliria ekonomike, gjegjësisht nga varshmëria prej rrogës edhe prej preferencave politike të punëdhënësit, dhe kujt i shërben gazetari në kësi kushte dhe rethana? Pastaj çdokush duhet të sjellë vendim, por edhe të merr përgjegjësi nëse ajo nuk është në interes të profesionit.

INTERVISTË

Enes OSMANÇEVIQ

Promovimi i standardeve profesionale dhe etike përmes gazetarëve redaktorëve është kyqë për mbrojtje të profesionit në Internet

Cilat janë sfidat në mbrojtje të gazetarisë etike dhe profesionale në Internet dhe cili është roli i mekanizmave vetëregullues. Për këtë temë kemi folur me Enes Osmançeviq, profesor në Fakultetin Filozofik në Tuzla, në fakultetin për shkencë politike në Sarajevë dhe anëtar i këshillit për Shtyp dhe Internet media në Bosnje dhe Hercegovinë



KEMM: Si, në pika të shkurtëra do ta kishit përshkruar situatën me respektimin e standardeve etike dhe profesionale në onlajn mediat, në dallim me mediat tradicionale?

E.O: Standardet profesionale dhe etike thyhen në mediat tradicionale edhe në ato të Internetit. Por, për hire të së vërtetës, kjo është rast më së shumti te Internet mediat, edhe për këtë ekzistojnë disa arsye. Internet mediat veprojnë në sajber hapësirën e cila karakterizohet me shkallë më të lartë të lirisë të komunikimit dhe jore-daktimit të përmbajtjeve. Varësisht nga ligjet shtetërore, onlajn mediat, kryesisht, nuk i nën-

shtrohen donjë rregullimi të rrept. Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, për të krijuar një onlajn media nuk nevojitet asnjëfarë lloji të lejes, madje as nuk duhet të regjistrohet në regjistrin gjyqësor. Këtë situatë me onlajn mediat e spjegon Nikollas Negroponte me konstatimin se çdo individ në rrjetin global të Internetit është një TV stacion potencial e cila nuk ka leje transmetim. Për dallim nga onlajn mediat, të cilat në këto regjione janë të përbëra nga disa grupe të vogla të individëve të cilit nuk kanë obligim të arsimohen në fushën e gazetarisë, mediat tradicionale kanë një strukturë më të fortë të theksuar, organizim dhe një numër më

të madh të të punësuarëve me një shkollim më adekuat. Por, siç janë të obliguar mediat tradicionale të respektojnë ligjet dhe kodekset gazetareske, ashtu janë të obliguar të veprojnë edhe onlajn mediat. Në BH ekziston kodeksi i vetëm për mediat e shtypura dhe onlajn mediat, për respektimin e të cilit kujdeset Këshilli për shtyp, përmes mekanizmave për vetëregullim. Ndërsa, televizionet dhe radiot janë të përfshira me mekanizma të regulatorëve të cilat i zbatojnë Agjencioni regulator për komunikim.

KEMM: Duke pasur parasysh lirinë dhe mundësitë e pakufizueshme të cilat i ofron internet hapësira, në cilën masë mendoni se onlajn mediat e abuzojnë atë liri duke praktikuar gazetari joprofesionale?

E.O: shumë abuzime janë prezente në hapësirën e komunikimit në Internet. Më së shpeshti, kjo është të komunikimit anonim e cila lejon shfrytëzimin e më shumë identiteteve, nga të cilit asnjëri nuk duhet të jetë i vërteti. Këto abuzime më së shumti manifestohen përmes vjedhjes të identiteteve, pronësise intelektuale, plagjiaturës, gjuha e urrejtjes, dhe nxitja e dhunës. Përveç, gazetarisë joprofesionale, në Internet kemi edhe komentet nga përdoruesit diskutimet në forume të ndryshme dhe blogat të cilat karakterizohen me përmbajtje jo të redaktuara. Në moment ka shumë debate për ardhmërinë e Internetit, rregullimi i pronës intelektuale dhe identifikimi i komunikacionit, me qëllim që të zvoglohet numri i abuzimeve. Por, edhe këto debate shpesh here abuzohen, edhe ashtu ngelet të shohim se si gjithë kjo do të përfundon.



Intervistë - Enes OSMANÇEVIQ



KEMM: Në garrën e klikimeve dhe reklamave, cilat aspekte të thyerjes të standardeve etike dhe profesionale në Internet hapësirën janë më brengosëse?

E.O: Më brengosëse janë përmbajtjet e rejshe dhe jo të vërteta të cilat çdo ditë publikohen në një numër të madh onlajn media. Kjo, në esencë, do të thotë senzacionalizëm i cili publikohet vetëm me një qëllim të vetëm që të përfitohen sa më shumë klikime. Përveç kësaj, këtu kemi thyerje të postulateve themelore gazetareske, sipas të cilave përmbajtjet komercijale dhe informative duhet të jenë të ndara. Por, pavarësisht nga ajo, çdo ditë shofim si përmbajtje komercijale, gjegjësisht-reklame, promovime dhe propaganda ekonomike paraqiten si përmbajtje informative. Gjithashtu, brengos edhe gjuha nxitëse që në mënyrë të vazhdueshme servohet në Internet si një lloj spektakli edhe si arenë për betejë verbale. Kjo shumë shpesh shëndrohet në gjuhë urrejtjeje, dhe nxitje në dhunë, ku në shumë legjislacione është vepër penale, e cila sanksionohet me denim burgu.

KEMM: Në çfarë mase mekanizmet rregullatore dhe ato vetëregullatore kanë sukses

t'u kundërshtohen thyerjes të standardeve etike dhe profesionale të onlajn mediave?

E.O: Mekanizmet për rregullim i përkufizon shteti, a në emrin e tyre i zbaton agjencioni i cili duhet të jetë i pavarur. Rregullimi nënkupton sanksione- gjoba, madje edhe marrje të licencës për transmetim. Vetëregullimi themelohet në pranim vullnetar të kodeksit etik, për zbatimin e të cilit është përgjegjës Këshilli për shtyp dhe onlajn media, siq është rasti në Bosnjë dhe Hercegovinë. Më tej, vetëregullimi nuk përmban mekanizma për sanksionim. Roli i saj është të mbrojtë mediat nga ndikimet politike, a publikun t'a mbrojtë nga gazetaria e jomirëfilltë. Në vitet e fundit, Këshilli për shtyp në BH në vit pranor me shumë se 1000 ankesa nga qytetarë në lidhje me përmbajtje të publikuara në mediat e shtypura dhe ato onlajn. Kjo tregon se publiku çdo herë e më shumë është i vetëdijshëm në lidhje me thyerjen e standardeve etike, por edhe në kredibilitetin e Këshillit për shtyp. Gjithashtu, shumica e ankesave të qytetarëve zgjidhen me anë të mediacionit, me publikimin e korigjimit. Promovimi i standardeve etike dhe profesionale dhe zbatimi i tyre konstant është

punë në vazhdimësi, ku nga njëra anë paraqet përkushtim, për profesionalizëm të mediave dhe avancim të standardeve gazetareske, a nga ana tjetër e edukon publikun dhe shfrytëzuesit dhe e avancojnë arsimimin dhe kulturën mediale.

KEMM: Si anëtarë i Këshillit për shtyp, si është përvoja e juaj e deritanishme me rastet e thyerjes e standardeve etike dhe profesionale në onlajn mediat?

E.O: Në Bosnjë dhe Hercegovinë, në periudhën para se Këshilli për shtyp t'a merrte obligimin për vetëregullim në fushën e onlajn mediave, kishte shumë raste të thyerjes të standardeve etike dhe profesionale nga ueb-portalet. Disa nga këto raste ishin të paraqitura por shumica e rasteve nuk paraqiteshin. Prej kur Këshilli për shtyp filloi me vetëregullimin edhe të onlajn mediave, shumica e portaleve i pranuan kodekset etike dhe u pajtuan për vetëregullim. Prej atëherë, shumë mund dhe energji është investuar për promovimin e standardeve etike dhe profesionale në mesin e redaktorëve dhe gazetarëve të onlajn mediave në BH, por edhe për edukim të shfrytëzuesve, para se gjithave nga aspekti për të drejtën e tyre për ankesë edhe për korigjim të publikimeve jo të sakta në onlajn mediat. Kjo, nga njëra anë, rezultoi me senzibilizim të rritur të shfrytëzuesve të onlajn mediave që të njohin thyerje të kodeksit gazetaresk në mediat e shtypura dhe ato onlajn, por gjithashtu, kontriboi edhe për rritjen e numrit të ankesave. Nga ana tjetër, kishim gadishmëri më të madhe nga redakcionet e onlajn mediave që të pranojnë mediacion, të publikojnë korigjim, ose të korigjojnë donjë përmbajtje e cila nuk është e saktë ose përmbajtje të cilat prej çfarë do lloj baze e thejnë kodeksin. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që të kemi sa më pakë thyerje drastike të Kodeksit domethënë sa më pak mosëmarrje përmes atyre që prodhojnë dhe atyre që konsumojnë produkte të onlajn mediave.

KEMM: Sipas jush, si mundet situatë edhe më shumë të përmirësohet në të ardhmenë afërdt dhe cili do të ishte qasja më e adekuatë në këtë drejtim?

E.O: Mendoj se promovimi i standardeve etike në mesin e gazetarëve dhe redaktorëve është qasja më e mire. Kjo është temë e vazhdueshme "e gjallë" për profesionin gazetaresk dhe rëndësia dhe aktualiteti i saj asnjëherë nuk do të përfundojë. Nga ana tjetër, duhet të punohet edhe me shfrytëzuesit e onlajn mediave, me qëllim të avancimit të njohurive të tyre digjitale dhe mediale. Këtu, përveç Këshillit për shtyp rëndësi të madhe kanë universitetet, fakultetet të cilat i arsimojnë gazetarët, ueb-dizajnerët, menaxherët, mësuesit, profesorët, politikanët, diplomatët, juristët dhe të gjithë kontribuesit në shoqëri.

INTERVISTË

Martin Hakerbi

Promovimi i standardeve profesionale dhe etike përmes gazetarëve redaktorëve është kyqe për mbrotje të profesionit në Internet

KEMM: Sipas jush, cila është puna më thelbësore e gazetarëve gjatë zgjedhjeve?

M.H: Gazetarët duhet të kërkojnë përgjegjësi nga ata të cilat sundojnë fuqinë dhe nga ata të cilat dëshirojnë të kenë fuqi, njëkohësisht, duke i rishqyrtuar konstatimet e tyre dhe duke ndjekur jopërputhshmëritë faktike. Kjo, gjithashtu, nënkupton edhe studim dhe spjegim të qëllimeve kryesore të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

KEMM: Cilat pikëpamje në raportimin zgjedhor janë me domethënie thelbësore për informim objektiv dhe profesional të qytetarëve në procesin e vendimit?

M.H: Hulumtim të përkushtimeve të partive, domethënë krahasimi i tyre me të dhënat dhe gjendjen ekzistuese, si dhe kontrol të realizshmërisë të premtimeve politike. Në shtetet totalitare është rëndë të gjinden ekspert të pavarur, ose ata të cilit do të flasin për politikën të

cilat i ofrojnë partitë. Në situatë të tillë, do ishte e kuptueshme të shikohen përvojat jashta kufijve dhe në vendet përreth, që të shifet se vallë në ato shtete kanë funksionuar ide të ngjajshme dhe si janë komentet e ekspertëve të atjeshëm në drejtim të asaj se sa reale dhe e realizueshme mundet të jetë një politikë konkrete.

KEMM: Në cilin nivel mundet raportimi gazetaresk të ndikon mbi motivimin e qytetarëve në pjesëmarrjen e tyre në procesin e votimit?

M.H: Raportimi i mirë mundet të ngazëllojë publikun dhe ti tregoj rëndësinë për zgjedhje thelbësore, por, mediat, gjithashtu, munden edhe t'a qkyqin publikun nga ngjarjet zgjedhore. Raportimet e pafundme të betejave politike të kandidatëve të ndryshëm dhe të partive, në një farë mënyre, munden ta bëjnë publikun jo të interesuar për procesin zgjedhor. Gazetarët shpeshherë habiten pas deta-

Cili është roli kryesor i gazetarëve gjatë zgjedhjeve? Çka është e rëndësishme për informim objektiv dhe profesional të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor? Cili është roli i trupave vetëregullues për të siguruar mbulim të zgjedhjeve të balancuar dhe profesional?- Këto janë vetëm disa prej pyetjeve të cilat i biseduam me Martin Hakerbi, ekspert medial edhe gazetar dhe redaktor shumëvjeçar në media udhëheqëse në Angli. Martin Hakerbi është gazetar dhe redaktor i mëparshëm në "The Times", në Londër, dhe redaktor në redakcionin e jashtëm të "The Observer". Pas disa viteve punë si redaktor në "The Prague Post", tani punon në nivel botëror si trajnues i gazetarëve dhe si konsulent i redaktorëve në gazeta dhe agjencione lajmesh. Puna e tij e kohëve të fundit përbëhet edhe prej trajnimeve për gazetarë të cilit raportojnë për tema politike në mediat elektronike dhe të shtypura në Nepal dhe Sudan.



Intervistë - Martin Hakerbi



jeve të lidhura me ngjarjet politike, duke i injoruar pamjen më të gjërë. Raportimi për atë se çka është t'u ndodhur, se kush ngjitet lart e kush poshtë në betejat politike, mundet të jetë gjithashtu interesante si komentimi i donj lojë sporti, por kjo sdo të thotë edhe nxerja në dritë e donjë situatë komplekse.

KEMM: Duke pasur parasysh përvojën e juaj ndërkombëtare si konsulent dhe trajnues, cilët pikëpamje nga raportimi medial në shtetet me shkallë të ulët të zhvillimit demokratik i konsideroni si më problematike, për dallim prej shteteve të zhvilluara?

M.H: Shpesh here kjo më shumë është pyetje inteziteti, se sa diçka tjetër. Ekziston problem thelbësor në konfuzionin reth rolit të gazetarëve. Për shembull, në gazetë, gazetarët të cilit raportojnë për zgjedhjet mundet të jenë në rolë të ndryshme, si "raportues" ose si "raportues politik". Duke pregaditur analiza dhe lajme, por edhe si "komentues", ose "opinionist", duke ofruar pikëpamjet e tyre për ngjarjet nga procesi zgjedhor. Gjithashtu, ata mundet të jenë edhe në rolin e "redaktorëve, ose "pendat udhëheqëse në redakcion", duke përfaqësuar politikën redaktuese të gazetës, madje edhe "propagandist", të cilit janë përcjellës të kauzës të donjë partie, për llogari të tjerëve. Gazetarët mundet të pranojnë disa prej këtyre roleve, por këtu vjen pyetja - ne bazë çka-je lexuesi do të gjykon për besueshmërinë e asaj çka i u është thënë? Radiodifuzerët shtetëror, me siguri ballafaqohen me sfidat më mëdhaja. Ata duhet të tregojnë moral dhe etikë të përsosur, për të duruar kërkesat e partisë në pushtet për të raportuar në interesin e saj. Por, megjithatë, raportimi për procesin zgjedhor në shtetet me zhvillim demokratik jo të mjaftueshëm mundet të ketë edhe anë pozitive, për arsye se, për shembull, mediat në shtetet e "zhvilluara" shpesh here preokupohen me personalitetin e liderëve, duke u fokusuar në komenetet e tyre, veshja, qëndrimi, gafet minimale, që shpesh here edhe mungon raportimi për politikën e tyre.

KEMM: Sipas jush, cilat janë arsyet më të shpeshta për raportim joprofesional gjatë zgjedhjeve në shtetet ku keni punuar deri tani?

M.H: Numër i madh i problemeve janë të përbashkëta për të gjitha llojet e raportimeve në shtetet e kësaj lloji - media të vogla, të cilat shpesh here janë pak të paisura ose nuk kanë mjete financiare, të punësuar të cilit janë pak të paguar, ose, në numër të madh janë jo të trajnuar dhe jo kompetent që të punojnë për raportim korrekt, të balancuar dhe

thelbësor. Shumica e shtëpive mediale kanë pronarë të cilit për qëllim kanë gjatë zgjedhjeve të sigurojnë ndikim politik dhe përfitim financiar. Anësimi politik i disa gazetarëve gjithashtu është problem, ato janë, apo do të bëhen përfaqësues të njerëzve për të cilit ata raportojnë. Madje edhe ata të cilit orvaten të janë të balancuar mundet të anësojnë nga ajo rrugë duke ndjekur donjë lider gjatë fushatës së tij.⁴

KEMM: Si duhet të vazhdon zhvillimi profesional i gazetarëve dhe redakcioneve me qëllim që të sigurohet raportim profesional gjatë zgjedhjeve?

M.H: Mungesa e trajnimit të nevojshëm për gazetarët është problem i përbashkët për shtetet më pak të zhvilluara në kuptim politik. Shtetet e mëparshme komuniste mundet të kenë vështësi të veçanta, duke pasur parasysh, se studimi teorik i gazetarisë ka kontribuar që shumë gazetarë të mos jenë të pregaditur mjaftueshëm që të zgjedhin problemet praktike të lidhura me raportimin. Programi i vazhdueshëm i këshillimit dhe trajnimit praktik mundet të ju ndihmojë gazetarëve në këto shtete, që të zgjedhin sfidat të cilat i imponojnë politikanët e fuqishëm, por edhe të ju mundëson të hulumtojnë temat të cilat janë më të rëndësishme për votuesit.

KEMM: Ku e shikoni rolin e trupave vetëregullues, siq është Këshilli për etikë në media në Maqedoni?

M.H: Këto trupa i vendosin rregullat për raportimet mediale, ata mundet t'i përkujtojnë gazetarët se si duhet të sillen, por edhe të ju ndihmojnë dhe ti frenojnë shpërthimet dhe incidentet e ndryshme të cilat pa përjashtim ndodhin gjatë zgjedhjeve. Por, me siguri roli më thelbësor është sigurimi dhe vëzhgimi i raportimit të pavarur dhe të balancuar për partitë e ndryshme në mediat. Trupa vetëregullues mundet të jenë element kyq në situata kur rriten tensionet, që është e pashmangshme gjatë betejave politike në proceset zgjedhore. Ata mundet të ofrojnë një refleksion të qetë dhe kahje të kuptueshme për gazetarët të cilit dëshirojnë të punojnë në mënyrë profesionale.